

BROSHURË INFORMATIVE
MBI
TË DREJTAT E TË DËNUARVE
ME BURGIM
DHE TË PARABURGOSURVE

*Në Institucionet e Ekzekutimit
të Vendimeve Penale*

TË DREJTAT E TË DËNUARIT

- Ti ke të drejtë të trajtohesh me dinjitet, njerëzisht, pa u diskriminuar për shkak të seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar, apo ndonjë dallimi tjetër.
- Në rast se i dënuari nuk di të lexojë e shkruajë, ai duhet të njihet me të drejtat e tij përmes leximit të ligjit apo rregullores nga personeli i burgut.
- Brenda 24 orëve nga pranimi në institucion, duhet të ekzaminohesh nga mjeku dhe stomatologu, të cilët të hapin kartelë personale.
- Duhet të qëndrosh në dhomën e pranimit jo më shumë se 10 ditë.
- Nëse je i mitur, duhet të vendosesh në institucione ose seksione të veçuara nga të dënuarit e rritur dhe të kesh trajtim të veçantë. Edhe ajrimi i të miturve bëhet veçmas.
- Të miturat e dënuara mbahen në mjedise të veçuara nga të miturit meshkuj.
- Gratë e dënuara vendosen në institucione ose seksione të veçuara nga burrat dhe mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin e personelit femëror.
- Nëse je shtatzënë apo lehonë, ke të drejtë të trajtohesh në qendra të specializuara të obstetrikës dhe gjinekologjisë jashtë burgut.
- Nëse je nënë e dënuar, ke të drejtë të mbash me vete

fëmijët nën 3 vjeç. Për kujdesin ndaj fëmijëve ka çerdhe të posaçme, nën kujdesin e specialistëve të pediatriës.

- Dhoma jote duhet të ketë ajrim të mjaftueshëm, ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar dhe energji elektrike për ndriçim dhe nevoja të higjienës personale.
- Shtresat, mbulesat për fjetje dhe veshjet janë personale, në përputhje me kushtet klimaterike dhe nevojat e tua dhe duhet të të vihen në dispozicion nga personeli i burgut.
- Ajrimi bëhet në mjedise të hapura çdo ditë, përfshirë festat zyrtare dhe jo më pak se dy orë në vendin e caktuar.
- Përveç ushqimit që të sigurohet në institucion, mund të marrësh 4 herë në muaj ushqime (deri në 5 kg ushqime, 3 kg fruta, lëngje me ambalazh të tejdukshëm e të hapur) nga familja, ose t'i blesh nga njësia e tregtimit në burg. Cigaret nuk llogariten në peshën e ushqimeve.
- Ke të drejtë të arsimohesh, të marrësh formim profesional, të kryesh veprimtari kulturore e sportive.
- Ke të drejtë të punosh kundrejt shpërblimit dhe koha e punës të të përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni pleqërie. Nuk mund të detyrohesh të punosh nëse je në kushtet për pension pleqërie, invalid i grupit I dhe II, grua shtatzënë, ose nëse nuk je në gjendjen e duhur shëndetësore.
- Nëse punon, ke të drejtë të të sigurohet ushqim suplementar pasdite, sipas rekomandimit të mjekut, në përshtatje me punën e kryer.
- Ke të drejtë të ushtrosh besimin fetar në mjedise të veçanta.

- Ke të drejtë të kërkosh ushqim të ndryshëm për shkak të ndërgjegjes ose besimit fetar, në përputhje me rregullat fetare dhe mundësitë praktike në institucion.
- Shërbimet e nevojshme të kujdesit shëndetësor i përfiton pa pagesë, pa diskriminim dhe në nivel të barabartë me atë në komunitet.
- Nëse ke nevojë të vizitohesh duhet t’i paraqesësh kërkesën personelit mjekësor përkatës.
- Nëse je sëmurë, institucioni të siguron dietë të veçantë pas propozimit të mjekut të institucionit.
- Ke të drejtën e trajtimit të specializuar në rast problemesh të shëndetit mendor.
- Nëse je me HIV/AIDS, ke të drejtë të ruash konfidenciale gjendjen tënde, të marrësh pjesë pa diskriminim në punë dhe në veprimtari sociale.
- Nëse je me HIV pozitiv, ti nuk duhet të izoloohesh për këtë shkak.
- Ke të drejtë të takosh ose kontaktosh familjarët dhe persona të tjerë në vende të veçanta. Personeli kontrollon takimet nëpërmjet shikimit dhe nuk ka të drejtë të dëgjojë.
- Ke të drejtë të takosh e kontaktosh, edhe me telefon, avokatët, duke pasur kohë të mjaftueshme dhe në konfidencë të plotë.
- Ke të drejtën e fshehtësisë së korrespondencës dhe të drejtën e bisedave telefonike 8 herë në muaj me të afërmit, duke deklaruar më parë numrin që do të thirret. Në mungesë

mjetesh financiare, të sigurohen falas 5 minuta telefonatë në muaj.

- Ke të drejtë të paraqesësh kërkesa dhe ankime mbi respektimin e të drejtave të tua ligjore. Këto i drejtohen me gojë, ose me shkrim, edhe në zarf të mbyllur: drejtorit të institucionit, inspektorëve, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe ministrit të Drejtësisë; gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit dhe prokurorit të rrethit, Avokatit të Popullit dhe cilitdo organi shtetëror ose organizate joqeveritare brenda dhe jashtë vendit.

- Në rast shkeljeje disiplinore, mund të ndëshkohesh vetëm pasi janë dëgjuar dhe verifikuar pretendimet e tua.

- Ke të drejtën e lejes shpërblyese deri në 20 ditë dhe të lejes së veçantë deri në 30 ditë në vit. Për të miturit, leja shpërblyese është deri në 45 ditë në vit.

- Pas lirimit nga burgu, ke të drejtë të marrësh me vete të gjitha sendet personale dhe të hollat e depozituara në llogarinë tënde, sipas procesverbalit të dorëzimit të firmosur prej teje dhe punonjësit të autorizuar të institucionit.

DETYRAT E TË DËNUARIT

- Të bashkëpunosh lidhur me procedurat e identifikimit dhe të kontrollit mjekësor gjatë pranimit në institucion, apo gjatë kontrolleve nga personeli.

- Të mbash të pastër e të rregullt dhomën tënde dhe mjediset

e përbashkëta.

- Të kujdesesh për higjienën personale.
- Të mos mbash dhe qarkullosh sende të ndaluara, që rrezikojnë rendin, jetën dhe shëndetin e të dënuarve dhe personelit, ose mjete që ndikojnë negativisht në hetim.
- Të krijosh marrëdhënie korrekte me të dënuarit e tjerë dhe me personelin e institucionit.
- Të zbatosh me korrektësi urdhrat e personelit të institucionit.
- Të dëmshpërblesh vlerën kur shkakton dëme materiale ndaj pronës së institucionit ose të dënuarve të tjerë.
- Të respektosh dinjitetin e atyre që të rrethojnë.
- Të informosh menjëherë drejtorin e institucionit kur ka rrezik për sigurinë, jetën ose shkeljen e rregullave.
- Nëse je i mitur, duhet të plotësosh kërkesat për arsimim dhe formim kulturor e profesional nëpërmjet shkollës.
- Të respektosh kërkesat e regjimit të mbikëqyrjes së veçantë që zbatohet për ty.
- Të respektosh kohën dhe vendin e lejes që të është dhënë.
- Të respektosh të gjitha rregullat e dhëna dhe të njoftosh institucionin për çdo shmangie të imponuar.

TË DREJTAT E TË PARABURGOSURIT

- Ti gëzon të drejtat dhe ke detyrimet e parashikuara për të dënuarit. Gjithashtu ti ke edhe të drejtat e mëposhtme:

- Të drejtën të prezumohesh i pafajshëm, të mos detyrohesh të dëshmosh kundër vetes ose familjes dhe as të pohosh fajësinë.
- Të njoftohesh menjëherë dhe në gjuhën që kupton për akuzën në ngarkim dhe për të drejtën për të mos bërë deklarata.
- Të informohesh mbi të drejtën për të pasur avokat.
- Të lejohesh të komunikosh menjëherë, lirisht dhe privatisht me avokatin personal ose të të sigurohet mbrojtja falas kur nuk ke të ardhura të mjaftueshme.
- Të paraqitesh brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili brenda 48 orëve të tjera nga marrja e dokumenteve për shqyrtim, vendos paraburgimin ose lirimin, si dhe të ushtrosh të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjyqtarit.
- Të dëgjohesh përpara se të gjykohesh në një gjykim të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

AVOKATI I POPULLIT

Avokati i Popullit, në rolin e *Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës*, ka të drejtë të mbikëqyrë zbatimin e *Ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*. Në zbatim të *Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës (OPCAT)*, Avokati i Popullit mund të vëzhgojë nëpërmjet vizitave të rregullta, trajtimin tënd në burgje dhe në institucione të paraburgimit, për të parandaluar rastet e

torturës e të trajtimit të egër që mund të të bëhet, si dhe për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të tua. Avokati i Popullit i paraqet problemet e evidentuara në raporte dhe rekomandime për organet përkatëse, me qëllim respektimin dhe përmirësimin e standardeve të trajtimit tënd. Nëse vlerëson se të drejtat e tua janë shkelur, ti mund të ankohesh ndaj policisë, burgjeve, shërbimit sekret dhe pushtetit gjyqësor. Ankesat e tua do të trajtohen nga *Seksioni i Veçantë* i Institucionit të Avokatit të Popullit brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Kontakte

- ❖ Numrat e telefonit:
 - a) 0800 1111 - falas gjatë orarit zyrtar, 8:00-16:00
E Hënë - E Premte
 - b) 068 90 34 648 - numër i hapur 24 orë, çdo ditë
të javës

- ❖ Adresa:
Avokati i Popullit, Blv. “Zhan D’Ark”, Nr. 2, Tiranë

Ky botim u mbështet nga  Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezencë në Shqipëri

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë detyrimisht
pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.